



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**



### EK STRAKT I PROCES VERBALIT

**të mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 20.02.2019,  
duke filluar në orën 09:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Vala Peshku, Halim Halimi, Agim Gashi, Jeta Rafuna, Sami Boroci, Eman Rahmani, Fadil Gashi dhe Egzon Azemi.

**Munguan:** Blerand Stavileci dhe Genc Sherifi.

**Në mbledhje morën pjesë edhe:** Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Pronës, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshmë, Valbona Ahmeti - Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Burbuqe Hydaverdi, përfaqësuese e Drejtorisë së Urbanizmit, Premtime Preniqi, koordinatore për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, Qëndrim Arifi, përfaqësues nga INPO-ja, Faton Ajeti, përfaqësues nga OSCE-ja, dhe KFOR LMT-IT.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit **Agim Kuleta, kryesues.**

Para se të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, **Agim Kuleta, kryesues,** tha se përveç pikave që i kemi në rend dite, kemi edhe propozime të tjera që të përfshihen edhe pika të tjera në rendin e ditës.

**Genc Bashota** bëri të ditur se është fjala për inicimin e dy projekteve, të cilat nuk kemi mundur t'i përfundojmë. Fjala është për kolektorin, për të cilin shpronësimi po na kushton shumë dhe nuk kemi pasur para me i shpronësuar, andaj dhe kanë ngecur projektet, kështu që ne kemi bërë inicimin që një pjesë të tokave përreth kolektorit, me i shpronësuar me koeficiente të ndërtimit, sepse opsjon tjetër nuk kemi, sepse fond për shpronësimë nuk kemi. E njëjtë gjë vlen edhe për rruga "A", d.m.th. jo e gjithë rruga, një pjesë e rrugës "A" mund të shpronësohet me koeficiente dhe një pjesë e rrugës "B" që ndërlidhet me rrugën "A".

**Dren Kukaj propozoi që të futet në rendin e ditës ky propozim: Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Bahri Hoxhës dhe Besnik Asllanit.**

**Kryesuesi hapi diskutimin rreth rendit të ditës.**

**Halim Halimi** shprehu shqetësimin, duke thënë se vazhdimisht po e përsërisim se nuk sillen pikat e reja në fillim të mbledhjes, sepse ato duhet të lexohen dhe të analizohen. Kjo që po bëhet është një praktikë e keqe.

Sa i përket planeve irregulluese, ne për të satën herë e kemi thënë se nuk hartohen planet rregulluese pa Hartë zonale, jemi bërë të tepërt duke e përsëritur qe 5-6 vjet. Bëhet Harta zonale dhe iniciohet në hartimin e planeve të hollësishme rregulluese, ngase kështu po veprojmë në kundërshtim me Ligjin mbi planifikimin hapësinor, po bëjmë shkelje ligjore.

Ai u shpreh kundër futjes së pikave në rendin e ditës në këtë mënyrë.

**Agim Gashi** parashtroi pyetje lidhur me propozimin për fillimin e ndryshimit, apo si po thuhet "hartimit", po kuptohet se ka me u bërë një ndryshim aty, se është fjala për ndryshime të tërësishme, atëherë është mirë me korrektuar formulimin e kësaj. Meqenëse është vetëm korrektimi, apo përmirësimi i pjesëve ku ka pengesa në realizimin e projekteve bazike, pse nuk e mbuloni me proceduar, në bashkëpunim me Ministrinë, përmes kërkesave të veçanta, në mënyrë që edhe ne ta kemi një farë arsyetimi ligjor administrativ që ka lejuar Ministria, sepse ai udhëzimi administrativ nuk e specifikon qartësisht se kemi të drejtë të ndërhyjmë.

Qe 6 vjet janë shtyrë këto punë rreth rrugës "A", kolektorit, duke thënë se s'ka para! Nuk është arsyaja mungesa e mjeteve, por nuk është punuar në këtë drejtim, në krijimin e kushteve për zbatimin e këtyre projekteve, janë shtyrë këto procese, kur dihet se  $\frac{1}{4}$  e qytetit të Prishtinës jetojnë në ujëra të zeza. Nuk është pak nëse kryhet ajo pjesë, ku po investohet komplet pjesa e re e Prishtinës.

**Eman Rahmani** tha se edhe në mbledhjet e mëparshme kemi thënë se nuk kanë me qenë vetëm ato plane të hollësishme që do të vinin në Kuvend dhe kemi me i proceduar. Në çdo mbledhje kemi me pasur plane të tillë, varësisht prej interesave dhe varësisht si kanë me ju ardhur këtyre. Për mua është shumë shqetësuese ky fakt, që asgjë nuk po punohet në Hartën zonale dhe Planin zhvillimor, por sillen kësi lloj planesh të hollësishme, që realisht janë selektuse ndaj lagjeve dhe ndaj qytetarëve, ku bëhet zgjedhje vetëm e disa pjesëve të Prishtinës.

Ne nuk do të mbështesim asnjë plan të hollësishëm pa përfundimin e Hartës zonale dhe Planit zhvillimor.

Ai propozoi që të tërhiqen këto dy pika dhe të futet si pikë e rendit të ditës "Diskutim mbi gjendjen e punës së ekzekutivit për Hartën zonale dhe Planin zhvillimor". Po ashtu, të futet në rend dite edhe një pikë, që e ka përmendur edhe Samiu, "Informatë për Planin e mobilitetit".

**Fadil Gashi** kërkoi që në Kuvend, drejtori apo ekspertët që janë duke punuar në Hartën zonale, të na informojnë deri ku kanë mbërri me Hartën zonale dhe a do të funksionojë ajo Hartë zonale, apo vetëm ku kanë lidhje do t'i sjellin pikat për pronat individuale.

**Sami Boroci** u shpreh se sa i përket këtyre pikave të propozuara, pajtohem që të futen në rend dite, të drejtorëve në këtë rast. Arsyë pse i propozoj këto pika me i përkrahur përfutje në rend dite, është se nuk e shoh të arsyeshme me u bllokuar asnjë projekt kapital. Në bazë të deklarimeve të Drejtorisë, besoj se do të përfundojë hartimi i Hartës zonale.

Edhe unë jam dakord që në seancën e radhës ta kemi një informacion më të detajizuar nga drejtori lidhur me Hartën zonale.

Sa i përket Planit të mobilitetit, ai kërkoi që të futet në rend të ditës pika "Informatë për procesin e Planit të mobilitetit".

**Genc Bashota** tha se në vitin e kaluar në Kuvend e kemi sjellë Vendimin për Hartën zonale dhe Planin zhvillimor, dhe kemi deklaruar se përafersisht për 18 muaj mendojmë se mund ta kryejmë. Jemi duke punuar në këtë drejtim, por ka sfida. Unë mund të ju informoj për detaje në momentin që ju kërkon, ndërsa akuza pse nuk është bërë deri tanë, janë akuza pse nuk e ke bërë para kohe. Nuk mundemi me bërë para kohe, nuk ka gjasa teorike. Të gjitha sqarimet që i kemi marrë prej Ministrisë, thonë se kemi të drejtë me bërë plane rregulluese të hollësishme, që është në përputhje me PZHK dhe normat teknike të planifikimit, i cili integrohet në Hartën zonale.

**Egzon Azemi** iu përgjigj z. Bashota, duke thënë se askush nuk po të akuzon pse nuk e ke kryer planin, mirëpo e kemi përmendur afatin që e ke cekur se zgjat 18 muaj. Ky afat nëse zgjat 18 muaj, atëherë planet rregulluese të hollësishme janë të kota, për shkak se secili prej këtyre planeve, ta kemi shpjeguar në mënyrë të detajuar se zgjat së paku 6 muaj, kështu që nëse Harta zonale përfundon para afatit i kishte përfshirë edhe këto.

Ai shprehu mendimin se në seancën e radhës është shumë e rëndësishme me qenë si njoftim prej drejtorit, se deri në cilën fazë të këtij plani keni mbërritur.

**Dren Kukaj** dha sqarime, duke cekur se e vetmja mundësi për t'i trajtuar këto projekte, është përmes koeficientit të ndërtimit, kështu që nëse e kuptioni rëndësinë e këtyre projekteve, me urgjencën e kohës votohen këto propozime.

**Vala Peshku** pyeti se çka ka dallim kolektori nga shkolla, pse nuk mundesh me votuar kolektorin e shkollën mundeni, tregoma arsyen. A e dini se çka është kolektori, çka mbledh kolektori, a e dinë çfarë ere kundërmon?! Nëse je për shkollën, atëherë pse nuk je për kolektorin, ku është arsyeshmëria këtu nëse nxirret vendim dhe harta zonale?!

**Eman Rahmani** theksoi se ajo çka po kërkojmë ne, është zgjidhja e problemit për secilën lagje edhe për kolektorin dhe për secilën shkollë, në mënyrë sa më të shpejtë për ta zgjidhur këtë problem. Nëse mendojmë se vonohet Harta zonale, në rregull, duhet me hy në secilin plan rregullues të hollësishëm. Nëse thirrem se Harta zonale përfundon në afatin kohor që është i paraparë me ligj, atëherë nuk ka nevojë me i iniciuar këto projekte, sepse këto projekte zgjasin më shumë se afati ligjor i përfundimit të Hartës zonale, se këto vetëm e shtyjnë afatin kohor të hartimit zonal, për shkak se në këto plane do të punojnë njerëz që kanë me punuar në planifikimin dhe hartimin e Hartës zonale.

**Fadil Gashi** u shpreh se asgjë të keqe nuk ka nëse i thirri shefat e GP-ve, me iu treguar me ekspertë se deri këtu ka mbërrri Harta zonale.

**Genc Bashota** dha sqarime, duke thënë se këto dy plane janë emergjente, që besoj se mund të kryhen për 3 muaj. Këto aspak nuk e ngadalësojnë procesin e Hartës zonale, sepse këtë punë e kryejmë ne si Drejtori e Planifikimit.

**Agim Gashi** theksoi se u kuptua në fillim se është fjala për korrektim, për të ndërhyrë në ndonjë segmente të rrugës, ndërsa këtu në titull po thotë për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm, e kjo nënkupton që ky plan do t'i nënshtrohet të gjitha procedurave të ndryshimit.

**Burbuqe Hydaverdi** dha përgjigje, duke cekur se plotësim dhe ndryshim i planeve është, por duhet të jemi në dijeni se Ligji i planifikimit ka ndryshuar kategorinë e planeve, tanë ka plane rregulluese të hollësishme, nuk mund të bëjmë ndonjë ndryshim dhe plotësim të planeve rregulluese urbane, sepse është kategori që nuk e njeh ligji.

**Agim Gashi** theksoi se ky ligj nuk lejon me hy në këto punë pa Hartë zonale.

**Burbuqe Hydaverdi** iu përgjigj, duke thënë se këtë e lejon ligji. Ne i kemi bërë shkresë Ministrisë për rastin konkret, të cilin e kemi pasur në procedurë të inicimit, dhe kemi marrë përgjigje prej Ministrisë se ai dokumente specifikon vetëm për lagjen, mirëpo na është thënë se pas një dokumenti tjetër mundeni me shfrytëzuar edhe për zonat tjera. Ne do ta dërgojmë në Ministri për çështje të ligjshmërisë, nëse e kemi të ligjshme vazhdojmë me dy rrugët, nëse jo nuk vazhdojmë.

**Egzon Azemi** tha se nuk mund të ndërtohet kështu krejt Prishtina, me bërë një shkresë, ajo është vetëm për rast specifik.

**Genc Bashota** bëri të ditur se në shkresën e Ministrisë shkruan për lagjen "Dodona", rasti "Dodona", për të cilën e kemi marrë dritën jeshile, nëse doni ju e dërgojmë një shkresë në Ministri, duke i pyetur se a kemi të drejtë me bërë plane rregulluese të hollësishme nëse ne e shohim të arsyeshme me prioritet këtë punë. Nëse ne e marrim prej Ministrisë një përgjigje të përgjithshme, atëherë duhet votuar këto plane.

**Kryesuesi** e hodhi në votim propozimin e z. Dren Kukaj, që të futet si pikë e nëntë e rendit të ditës "Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Bahri Hoxhës dhe Besnik Asllanit.

**Kryesuesi** konstatoi se njëzëri u miratua propozimi, që në ren dite të futet si pikë e nëntë "Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Bahri Hoxhës dhe Besnik Asllanit".

**Kryesuesi** tha se vërejtjet u dhanë, por a mundet deri në Kuvend me ardhur sqarimi nga Ministria për këto Plane rregulluese të hollësishme.

**Genc Bashota** tha se sqarimin ligjor e kemi.

**Kryesuesi** e hodhi në votim propozimin, që të futet si pikë e dhjetë e rendit të ditës "Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën "Mati 1", vazhdimi i rrugës "B" (Bahri Fazliu), pjesa e kolektorit.

**Kryesuesi** konstatoi se më 3 vota për dhe 6 kundër, u votua kjo pikë.

**Kryesuesi** e hodhi në votim propozimin që të futet si pikë e rendit të ditës:

**Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes "Kalabria", pjesa e kolektorit.**

**Kryesuesi** konstatoi se më 3 vota për dhe 6 kundër, u votua kjo pikë.

**Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e Eman Rrahmanit, që të futet si pikë e rendit të ditës në mbledhjen e rrallës "Informatë për hartimin e Hartës zonale të Komunës së Prishtinës dhe Planit zhvillimor komunal të Prishtinës".**

**Kryesuesi konstatoi se më 6 vota për dhe 2 kundër, u miratua që të futet si pikë e rendit të ditës "Informatë për hartimin e Hartës zonale të Komunës së Prishtinës dhe Planit zhvillimor komunal të Prishtinës".**

**Eman Rrahmani** propozoi që në renditje të pikave për Kuvend me qenë Informata për Hartën zonale para planeve rregulluese të hollësishme, se këto shkojnë për Kuvend edhe pse nuk kanë kaluar me votim.

**Egzon Azemi** tha se duhet të theksohet se cilat pikat kanë hyrë me votim në KPF, dhe cilat janë pa votim në KPF. Ju si kryesues, duhet ta përmendni qëndrimin e KPF-së.

**Sami Boroci** propozoi të futet si pikë e ren ditës "Informatë për procesin e Planit të mobilitetit".

**Kryesuesi e hodhi** në votim propozimin e z. Sami Boroci, që të futet si pikë e rendit të ditës "Informatë për procesin e Planit të mobilitetit".

**Kryesuesi konstatoi** se më 7 vota për dhe 1 kundër, u miratua që të futet si pikë e rendit të ditës "Informatë për procesin e Planit të mobilitetit".

**Kryesuesi e hodhi** në votim rendin e ditës me pikat e propozuara.

**Kryesuesi konstatoi** se njëzëri u miratua ky

#### REND I DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2018 (TM4);
3. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2018;
4. Propozimvendimi për miratimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2019;
5. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim NPK "Trafiku Urban", SHA, në Prishtinë;
6. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim Policisë së Kosovës;
7. Propozimrregullore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;

8. Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në komunën e Prishtinës 2019-2021;
9. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Bahri Hoxhës dhe Besnik Asllanit;
10. Informatë për hartimin e Hartës zonale të komunës së Prishtinës dhe Planit zhvillimor komunal të Prishtinës;
11. Informatë për procesin e Planit të mobilitetit;
12. Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën "Mati 1", vazhdimi i rrugës "B" (Bahri Fazliu), pjesa e kolektorit;
13. Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes "Kalabria", pjesa e kolektorit;
14. Të ndryshme.

#### Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratuan ekstrakti i procesverbaleve të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

#### Pika e dytë dhe e tretë

Raporti finansiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2018 (TM4);

Raporti finansiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2018;

**Valbona Ahmeti - Makolli** theksoi se ky raport është i bazuar në nenin 46 të Menaxhimit të financave publike, dhe jam përpjekur që t'i paraqes secilën sipas atyre pikave që janë. Unë kisha kërkuar nga ju si KPF, që ta vlerësoni si raport, ta paraqitni qëndrimin tuaj se a keni për të shtuar ndonjë informatë, ose a janë detalet sipas Ligjit, a po i përban të gjitha ato që parashihen. Është dashur të vijnë edhe drejtorët tjerë, që ta mbrojnë mënyrën se si janë ardhur deri te gjendja financiare që e kemi.

Po ashtu, ajo ceku se 71% e buxhetit të përgjithshëm është shfrytëzuar në vitin 2018, ku paga dhe mëditje kanë shkua 97%, mallra dhe shërbime 86%, shpenzime komunale 99.5%, shpenzime në subvencione dhe transfere 76% dhe shpenzime kapitale 43.54%. Detalet jam

përpjekur që t'i paraqes për secilën drejtori veç e veç. Janë bukur shqetësuese disa gjëra, që besoj se në mbledhje të Kuvendit do të vijnë edhe drejtorët tjerë dhe do t'i shqyrtojmë.

Shqetësimi më i madh, si Drejtori e Financave, është te llogaritë e arktueshme, që për vitin 2019 ne si drejtori e kemi bërë një plan të veprimit, dhe kisha kërkuar nga ju një ditë të mbajmë një takim me shefat e GP-ve, me dhënë mendimet tuaja si profesionistë. Unë e kam bërë një plan të veprimit, nuk e di a pajtoheni me atë plan, por ashtu është shqetësim i Drejtorisë së Financave edhe për detyrimet kontigjente, edhe aty kishte qenë mirë me pasur një plan të veprimit.

**Halim Halimi** shprehu shqetësimin, duke thënë se kurrë në historikun e Prishtinës gjendja, realizimi i buxhetit nuk ka qenë më i keq, d.m.th, shpenzimet e buxhetit të Komunës së Prishtinës. Këtë mund ta argumentojmë, kur kemi parasysh se prej një buxheti prej 86,387,000 € janë shpenzuar 61,331,000 €, e këtu hyjnë paga, mallra, subvencione, shpenzime komunale, kapitale dhe mbeten 25 milionë, pra kemi mbetje të buxhetit pa u shpenzuar, e kur dihen nevojat e qytetit të Prishtinës, nevojat për ndërtimin e shkollave, çerdheve, parkingjeve etj. Sa i përket të hyrave, duket që mirë 97%, por kur e analizojmë, del se jo ngase arkëtimi i të hyrave nga mbledhja e mbeturinave ka qenë e paraparë 5 milionë e janë realizuar 1 milion e gjysmë!

Te shpenzimet kapitale, buxhetin e Komunës e kemi pasur 38.573,000, janë harxhuar 16 milionë, do të thotë 43% të buxhetit! Nëse vazhdohet kështu, në vitin e ardhshëm jo 25 milionë, por në bazë të kësaj ecurie do të jenë gjysma e buxhetit të Komunës së Prishtinës për bartje. Siç po duket, Komuna e Prishtinës nuk po dinë me menaxhuar. Kemi drejtori që buxhetin e ka vetëm 7%, Drejtoria e Pronës 9%, Zhvillimi Ekonomik 7.4% etj.

**Agim Gashi** u shpreh se të gjitha çështjet të cilat dëshirojmë t'i trajtojmë rreth raportit, do t'i shprehim në mbledhje të Kuvendit, ndërsa pyetjes së drejtoreshës se a keni me thënë diçka lidhur me çështjen e dokumentit, të Raportit si dokument, unë mendoj se ky është i punuar mjaft me përgjegjësi dhe janë përbush ato parashikimet ligjore të një dokumenti, siç është Raporti vjetor finanziar buxhetor i Komunës së Prishtinës. Mirëpo për të qenë raporti më i çartë, është dashur të zbërthehen disa pozicione ligjore, dhe kjo nuk është bërë, p.sh. shpenzimi i subvencionit është paraqitur sipas drejtorive sa për qind janë shpenzuar dhe vlerën e tyre ne nuk e dimë, cilat projekte në fushën e bujqësisë janë subvencionuar, bletari, pemëtari, mbjellje e drithërave, apo çka tjetër, d.m.th. nuk është zbërthyer, andaj për Kuvend është mirë t'i bashkëngjiten edhe këto zbërthime Raportit, për ta ditur si këshilltarë që me pasur informacionin e qartë, se kjo ka vlerë për dokumentacionin, e kjo vlen edhe për Administratë, Kulturë, Sport etj.

Po ashtu, bëri pyetje se sa drejtori janë në Komunën e Prishtinës?!

**Osman Bllaca** dha përgjigje, duke thënë se janë 15 drejtori.

**Agim Gashi** lidhur me këtë th se herë thuhet se janë 16, herë 15, herë 14, por unë e kam dëgjuar kryetarin e Komunës në debat, duke thënë se janë 14 drejtori, në Raport nuk figurojnë këto, ke

mjete vetëm për 11 drejtori, ato a kanë qenë me versionin e vjetër apo nuk kanë qenë, mirëpo nëse janë 16, pse nuk e keni ndryshuar Statutin e Komunës së Prishtinës.

**Osman Bllaca** tha jo, se me Vendim të Kryetarit e kemi ndërruar atëherë Statutin, që Kryetari i Komunës ka të drejtë në themelimin e drejtorive dhe sektorëve dhe jemi e vetmja Komunë që mundemi me themeluar drejtori pa Kuvend.

**Agim Gashi** theksoi se jemi duke folur për Raportin buxhetor vjetor, ku duhet me i pasur pasqyrat e carta, skemën e çartë, në harmoni me Statutin e Komunës, duhet me qenë pjesë inkorporuse e Statutit.

**Valbona Ahmeti - Makolli** tha se kur e kemi punuar Raportin, ka mbetur siç është pranuar ashtu dhe në Ministrinë e Financave deri në vitin 2019, nuk kemi mundur me ua ndryshuar as kodet ekonomike drejtorive.

**Eman Rrahmani** u shpreh se ajo që po kërkoj, se di se a është e mundur me na ardhur transaksionet për secilën kategori se ku janë bërë këto pagesa dhe qysh janë bërë, sepse unë kam fakte se nuk tregon të vërtetën. P.sh. është shpenzimi 179 mijë euro te Tregu i qytetit dhe në fakt nuk ka shpenzime në këtë kategori, kjo është paraqitje jo reale, mbasi ekziston mundësia në Raport me na ardhur edhe pagesat çfarë pune dhe sa mjete janë paguar për secilën punë d.m.th. Raporti i detajizuar.

**Valbona Ahmeti - Makolli** tha se me Vendimin e Kryetarit, te Tregu i ri i kemi marrë ato mjete për pagesën e këstít të "Trafikut Urban", duke u bazuar në një vendim të Kuvendit të vitit 2016. **Egzon Azemi** u shpreh se e di që nuk është përgjegjësi e juaja, drejtoreshë, ndoshta më së paku, veç me kërkuar prej kolegëve të tjerë drejtorë, me na dhënë njëfarë arsyetimi për këto tejkalime të jashtëzakonshme, parashikime buxhetore, ose është planifikim i dobët.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2018 (TM4) dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2018 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e katërt**

**Propozimvendimi për miratimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2019.**

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për miratimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2019, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e pestë**

**Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim NPK "Trafiku Urban", SHA, në Prishtinë.**

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim NPK "Trafiku Urban", SHA, në Prishtinë, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e gjashtë**

**Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim Policisë së Kosovës.**

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim Policisë së Kosovës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e shtatë**

**Propozimrregullore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.**

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimrregullorja për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e tetë**

**Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në komunën e Prishtinës 2019-2021.**

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në komunën e Prishtinës 2019-2021, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Vala Peshku tha se neni 47, Rendi i ditës, te neni 47.1 "Rendi i ditës për takimin e Kuvendit të Komunës caktohet nga kryesuesi i Kuvendit të Komunës, në marrëveshje me Kryetarin e Komunës."**

**47.2 "Anëtari i Kuvendit të Komunës mund të kërkojë shtimin e një pike në rendin e ditës gjatë seancës së rregullt të Kuvendit të Komunës, e jo me ndryshim të pikave që kanë ardhur."**  
**Osman Bllaca tha se çështja që kërkohet të përfshihet në rend dite duhet të jetë e natyrës urgjente.**

**Mbledhja përfundoi në orën 10:30.**

**Procesmbajtësja  
Shyhare Islami**

**Faqe 9 nga 9**

**Kryesuesi i Komitetit  
Agim Kuleta**